



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 16.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 2 dhe 3/1 korrik 2018.
2. Diskutimi dhe miratimi i projektkalendarit të punës së komisionit për periudhën 17 – 20 korrik 2018.
3. Seancë dëgjimore me kryerregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zotin Valdrin Pjetri, për të dhënë informacione dhe shpjegime në lidhje me sipërfaqen aktuale të pronës ku ndodhet Teatri Kombëtar, ndryshimet që ka pësuar ndër vite, mënyrën e tjetërsimit të pronave rreth saj, si dhe pronarët kufitarë të pronës së Teatrit Kombëtar.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Ilir Beqaj (zëvendësues), Besnik Baraj (zëvendësues), Genc Pollo (zëvendësues).

Mungojnë:

Vilma Bello, Fatmir Velaj.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Atëherë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 2 dhe 3 korrik. Kush është dakord me procesverbalet? Të gjithë janë dakord.

Miratohet.

Dua t'ju njoftoj para se të fillojmë, meqenëse kemi edhe një defekt teknik, se është rënë dakord me kryesinë e komisionit për kalendarin e javës.

Sot kemi dëgjesën me kryeregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zotin Valdrin Pjetri, një dëgjesë e shtyrë që javës që shkoi. Kryeregjistruesi pasi e konfirmoi ardhjen, pas 20 minutash, u detyra ta tërhiqte konfirmimin për prezencën e tij. Ndaj, me kërkesën e tij, sot kemi seancën dëgjimore në lidhje me pronësinë, ndryshimin e pronësisë të Teatrit Kombëtar dhe të të gjitha pronave, të cilat përfshihen në ligjin për Teatrin Kombëtar, që sapo u kalua me votat e maxhorancës në Kuvend.

Nesër është parashikuar diskutimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Lindita Nikolla. Mendoj se kjo është një seancë shumë e rëndësishme për diskutimin e të gjithë problematikës dhe asaj që propozohet për arsimin parauniversitar.

Të mërkurë kemi seancë dëgjimore për këtë projektligj të sjellë nga ministria, më pas do të kemi diskutimin nen për nen dhe në tërësi.

Diskutimin dhe miratimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit” është rënë dakord të bëhet ditën e mërkurë. Orarin se kur do të zhvillohet do t'ju njoftojmë, pra do të jetë ose në drekë ose pasdite.

Ditën e premte do të kemi dëgjesë në lidhje me ecurinë e arsimit profesional, diskutimin nen për nen dhe në parim.

Kjo është pak a shumë ajo që kemi vendosur si kryesi e komisionit.

Luçiano Boçi – Në lidhje me kalendarin, meqenëse po e diskutojmë. Dita e premte zakonisht është justifikuar nga deputetët e maxhorancës se është dita e aktiviteteve në terren. Unë mendoj se ky është një arsyetim që qëndron. Edhe ne jemi në terren dhe kështu është dita e premte. Nuk jemi para një procedure të përshpejtuar për projektligjin, i cili do të diskutohet në parim ditën e mërkurë, nën për nën nuk e di...

Albana Vokshi – Është në seancë ditën e hënë.

Luçiano Boçi – Ta mbaroj, Albana.

Mund të jetë ditën e hënë, por ne nuk kemi urgjencë në kuptimin e procedurës së përshpejtuar. Nëse është të hënë apo është ditë tjetër, kjo është çështje e organizimit të parlamentit dhe nuk është çështje e organizimit të komisionit. Parlamenti të marrë të gjitha masat që në brenda një normaliteti të diskutojmë një marrëveshje shumë të rëndësishme. S'mund të bëjmë diskutime me goditje të përqendruar: hap një problem, pastaj një tjetër; hap një gropë, pastaj një tjetër; gropë arsimit, gropë teatri, gropë arsimit profesional. T'i kalojmë me shpejtësi se janë pushimet e verës, t'i futim një gjumë se e hanë shqiptarët. Jo, ka një problematikë të propozimi që sillet për projektligjin për arsimin parauniversitar, për gjendjen ku është arsimit profesional. Unë pretendoj se duhet një diskutim shumë serioz. Është hera e parë gjatë një viti që diskutojmë për arsimin profesional. Është harruar, nuk është përmendur nga ministritë e linjës, ajo e Arsimit dhe ajo e Financave. Nuk e gjej një togfjalësh të tillë në mediet që ngrenë shumë probleme, por nuk kanë faj mediet në këtë rast. Të diskutojmë në dy ditë një marrëveshje për arsimin profesional, më duket mungesë përgjegjshmërie nga ana e komisionit. Ta vendosim javën që vjen. Nuk na intereson ajo pjesa tjetër që nuk ka kohë parlamenti. E gjejnë këta kohën, kur duan, dhe bëjnë seanca të jashtëzakonshme. Ta kishin gjetur kohën, ta sillnin që ta diskutonim. Nuk më duket e arsyeshme që të vijmë ditën e premte të diskutojmë me shumë urgjencë për një gjë të tillë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Boçi!

Po sqaroj se një seancë është ditën e enjte. Seanca tjetër është ditën e hënë, pra kemi vetëm të hënë, pra sot, të martën, të mërkurën dhe të premten për të diskutuar dy projektligje. Sot kemi kryeregjistruesin, na mbetet e marta, e mërkura dhe e premja. Meqenëse duhet të kalojnë të gjitha para ditës së hënë, menduam së bashku me kryesinë e komisionit, që edhe ta diskutojmë në parim arsimin parauniversitar, edhe të lemë kohën e mjaftueshme që nesër, në prezencë të ministres Nikolla, të shtjellojmë të gjitha problematikat që nuk kemi mundur t'i ngremë këto kohët e fundit

dhe ditën e premte të bëjmë një diskutim dhe një dëgjese për arsimin profesional, që edhe atij t'i lëmë kohën e mjaftueshme.

Sikurse e përmendët edhe ju, janë dy ministri, nuk dihet se kush bën çfarë. Është një amulli totale. Ne vendosëm kështu, sepse kemi kohë të mjaftueshme për të bërë dëgjesat me ministrat dhe me palët e interesit dhe mbarojmë brenda një afati që na është kërkuar, sepse ditën e hënë duhet të futet në seancë. Nëse nuk biem dakord, do të votohet. Është e thjeshtë. Duhet të kalojmë kalendarin, që të vazhdojmë me çështjen tjetër, e cila është e rëndësishme.

Kejdi Mehmetaj – Për sa u takon ndryshimeve që kanë ardhur për ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, nuk pashë tek ato ndonjë ndryshim që prekte në mënyrë të drejtpërdrejtë fillimet e vitit të ri shkollor. Kështu që, nëse nuk është rakorduar mirë puna për kalimin në seancë, ne nuk kemi pse i bëjmë gjërat në mënyrë të nxituar. Deri tani kemi kaluar në mënyrë të nxituar. Të marrim kohën e nevojshme që të bëjmë diskutimet. Deputetët ditën e mërkurë, nga mëngjesi deri në darkë, do të merren me një çështje të caktuar, por nuk mendoj se i ezaurojnë çështjet. Edhe grupet e interesit nuk do të kemi mundësi t'i dëgjojmë të gjitha. Të marrim kohën e nevojshme. Unë jam dakord me kolegun parafolës që dita e premte është një ditë që e kemi të rezervuar për zonat tona elektorale. Kështu që nuk ka kuptim të vijmë e të bëjmë një seancë dëgjimore ditën e premte.

Për më tepër, dua t'ju kujtoj se kemi pasur mundësi të mblidhemi në këtë komision. Maxhoranca ka bojkotuar pa arsye, me pretekste të kota pas bojkotit, duke thënë se kanë pasur angazhime në zona. Ndërkohë, ditën kur vërtet jemi të angazhuar nëpër zona, tani e bëni punë për të përmbushur afatet që ju kërkon qeveria.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Po, Milva.

Milva Ekonomi – Në momentin kur ne nuk po biem dakord për kalendarin, besoj se zgjidhja më e mirë është ta hedhim në votë, sepse duke e hedhur në votë, kemi parasysh disa situata: së pari, kemi një kalendar nga Kuvendi që është miratuar. Ndërkohë, bashkë me zonjën Vokshi është diskutuar që projektligji për arsimin parauniversitar ka nevojë për hapësirë, për t'u diskutuar pak më gjerë dhe u parashikua të kishim një dëgjese me grupet e interesit. Kështu që kjo është parashikuar në këtë kalendar. Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A* i bën mirë arsimin profesional që të ketë një mundësi mbështetje. Nuk

kemi pse presim që t'i japim një shans arsimit profesional. Unë besoj se është mirë që këto projektligje të kalojnë. Në qoftë se nuk ka dakordësi, dakordësia e vetme është vota, pra ta hedhim në votë kalendarin.

Bujar Çela – Faleminderit!

Në respekt të opozitës dhe të kalendarit të punimeve të këtij komisioni, unë mendoj se më trajnimin që na ka bërë kryetarja si komision, jemi mësuar me oraret e gjata. Them të punojmë ditën e martë e të mërkurë me orar të zgjatur, që të kapim kohën dhe të jemi konform ligjit. Nuk ka nevojë as për ta votuar, se kjo është detyra jonë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, Bujar!

Ju do të bënit mirë të vinit dhe të mos bojkotonit, sepse ngaqë bojkotoni si maxhorancë, rrimë orar pa orar dhe vini kur ju japin urdhër. Ky është problemi i këtij komisioni. Nuk është problemi që ne punojmë orar pa orar. Ne jemi seriozë në ato që diskutojmë. Më vjen mirë që i kanë dhënë urdhër kryeregjistruesit; ju dhanë urdhër edhe juve që të vini më në fund. Mendoj se kjo është arritje.

Luan Baçi – Pa dashur të përsërit parafolësit, sinqerisht nuk më vjen mirë për mënyrën se si u shtrua problemi. Është bërë fakt i kryer dhe kot na i merrni mendimin kur edhe ju, edhe zëvendëskryetarja thatë se do ta hidhni në votë. E dimë që maxhoranca e miraton me votë. Është një ngarkesë shumë e madhe, pasi është e gjithë java e ngarkuar. Më duket një formalitet, pra duhet t'i kalojmë patjetër këto ligje, sepse do të mbyllet parlamenti ditën e hënë. Në qoftë se është për të bërë formalitet, ne deri tani formalitet kemi bërë, sepse ata vendosin çdo gjë me votë. Do të doja të kishte konsensus për këto gjëra dhe ato që thanë zoti Boçi dhe zonja Mehmetaj janë për të mirën e punës dhe jo për t'i kaluar me votë.

Mendoj se duhej të kishte konsensus. Edhe ju mendoj se jeni dakord që kjo është mbingarkesë dhe është një formalitet nëse do të bëhen menjëherë ditën e premte.

Them se do të ishte më e drejtë ta bisedonin më shtruar pa kaluar te vota. Duke parë insistimin tuaj të menjëhershëm, edhe të zëvendëskryetares, do të thotë që ne po flasim kot dhe se ju do ta votoni.

Milva Ekonomi – Ne kemi tri javë që diskutojmë për kalendarin...

Albana Vokshi – Po, Romeo.

Romeo Gurakuqi – Unë mendoj ta shtyjmë, sepse të paktën prej një viti jemi përpjekur të bëjmë një opozitë konstruktive në lidhje me ligjin respektiv. Shoh me shumë keqardhje se të gjitha vërejtjet e paraqitura nga opozita kanë të bëjnë me standardizimin e arsimit parauniversitar; me depolitizimin e arsimit parauniversitar; me drejtorët socialistë të të gjitha shkollave dhe të drejtorive arsimore, të cilët vazhdojnë të jenë prezentë në të gjithë sistemin me dorë të hekurt, njëlloj si para vitit 1990; me eksperimentin me rajonalizimin. Megjithëse ministres së Arsimit i kemi thënë disa herë se nuk duhet ta shkëputë dhe ta çmontojë Shqipërinë tradicionale në katër qendra të ndara, ajo po tenton përsëri ta largojë drejtorinë e arsimore rajonale nga Shkodra.

Po ashtu, një eksperiment po vazhdon edhe në sistemin e institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, të cilat merren me cilësinë e arsimit. Pa u pasqyruar të gjitha këto në ligjin që keni paraqitur, është e pamundur të vazhdojmë.

Zonja Zëvendëskryetare, në cilësinë e drejtueses të Grupit Parlamentar të PS-së në këtë komision, t'i adresohen ministres së Arsimit të gjitha vërejtjet, të cilat janë paraqitur nga deputetët e PD-së dhe të opozitës në këtë komision, dhe të pasqyrohen, ndryshe sistemi është një farsë e drejtuar nga PS-ja me dorë të hekurt dhe kundër ligjeve të pluralizmit.

Ju faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Nuk kemi dakordësi për kalendarin. Deputetët e opozitës kërkojnë më shumë kohë për të trajtuar çështje të ndryshme, siç janë: arsimi parauniversitar dhe arsimi profesional. Gjithsesi, duhet t'ju kujtoj se Konferenca e Kryetarëve ka vendosur që të dyja ligjet të kalojnë ditën e hënë, në seancën e fundit, në datën 23 korrik.

Gjithashtu, ju kujtoj se arsimi parauniversitar ishte për t'u kaluar këtë javë, por e shtymë. Pra, jemi një javë me vonesë dhe kemi vetëm këto ditë, të cilat u munduam t'i menaxhojmë. Ju lutem, mua më duhet të procedoj me votimin e kalendarit, sepse kemi një çështje tjetër shumë të rëndësishme për të diskutuar: çështjen e Teatrit.

Luçiano Boçi – Çështja është se është bërë praktikë nga Ministria e Arsimit, sigurisht në bashkëpunim me Kuvendin, që ligjet më të rëndësishme i kalon në korrik. Në korrik është kaluar ligji i arsimit të lartë dhe ligji i sistemit parauniversitar. Të gjitha bëhen në korrik, se është mbyllur shkolla, nuk ka diskutime, nuk ka interes. Nuk bëhet kjo, se jemi në parlament dhe duhet të jemi seriozë dhe të diskutojmë. Për çfarë jemi në parlament ne?! Për të ngritur dorën jemi? Është kollaj fare ajo: ne kundër, ju pro dhe mbaron gjithçka, pra vijmë këtu po bëjmë “ta”, po firmosim letrën

e procesverbalit, por nuk është serioze për komisionin tonë. Këto janë çështje shumë të rëndësishme. Janë çështjet e arsimit, janë çështjet e fëmijëve tanë. Si mund t'i kalojmë ne kështu? Hajdeni se kemi disa ndryshime; hajdeni se kemi një marrëveshje! Le të bëhemi pak seriozë! T'i ngjajë peni gëzofit. Jemi parlamentarë apo çfarë jemi?! Në qoftë se nuk jemi, atëherë jemi thjesht të punësuar dhe vazhdojmë bëjmë sikur.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po, Kejdi.

Kejdi Mehmetaj – Marrëveshjen e diskutojmë gjatë kësaj jave që të jetë gati për të hënë. Ndërkohë, për ligjin tjetër për arsimin parauniversitar ne propozojmë të marrim kohë. Kemi ligje që kanë nga dy vjet të depozituara në parlament, të cilat nuk janë diskutuar ende. Të mos bëjmë sikur e ka vendosur Konferenca, jo se është në kalendar, se duhet të kalojë patjetër dhe se nuk mund të behet ndryshe. Të marrim kohë dhe të bëhemi seriozë për ata që na dëgjojnë dhe na ndjekin.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Në fakt, për zhvillimin e dëgjësës ditën e premte ishte insistimi im që të bënim një dëgjësë para se ta kalonim në seancë dhe të merrnim informacion për arsimin profesional, sepse askujt nuk i prish punë një e premte paradite, pastaj ikim nëpër zona. Nëse nuk e bëjmë ne, asnjë ministër gjatë kohës së verës, sepse pushimet kanë nisur edhe që tani, nuk do të na vijë javën e ardhshme, por edhe gjatë javëve në vijim.

Siç e keni vënë re, në mënyrë të rëndomtë, kur nuk duan të përgjigjen për çështje shumë të rëndësishme, thjesht bojkotojnë dhe ky ishte insistimi im. Nëse nuk jeni dakord, atëherë e votojmë kalendarin. Po jua lexoj edhe një herë, sepse nuk mund të merremi më gjatë me këtë gjë, sepse po i marrim kohën një çështjeje tjetër shumë të rëndësishme.

Nesër në orën 10:00 do të kemi dëgjësë me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Lindita Nikolla, për çështjet e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Do të kemi rastin nesër të diskutojmë për të gjitha çështjet e arsimit.

Të mërkurën kemi seancë dëgjimore me aktorë të interesit për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe diskutimin dhe votimin nen për nen të tij. Gjithashtu, po të mërkurën, në një orë më të vonë, kemi edhe marrëveshjen për arsimin profesional.

Të premten kemi lenë dëgjesa për arsimin profesional.

A jeni dakord me kalendarin?

Ky kalendar kalon me votat e shumicës.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 16.07.2018, ora 11:15

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kryerregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zotin Valdrin Pjetri, për të dhënë informacione dhe shpjegime në lidhje me sipërfaqen aktuale të pronës ku ndodhet Teatri Kombëtar, ndryshimet që ka pësuar ndër vite, mënyrën e tjetërsimit të pronave rreth saj, si dhe pronarët kufitarë të pronës së Teatrit Kombëtar.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Ilir Beqaj (zëvendësues), Besnik Baraj (zëvendësues), Genc Pollo (zëvendësues).

Mungojnë:

Vilma Bello, Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Valdrin Pjetri – Kryerregjistrues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,
Merita Qato – drejtoreshë Juridike në ZRPP.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Vazhdojmë me çështjen e rendit të ditës. Kemi seancë dëgjimore me kryeregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zotin Valdrin Pjetri, për të dhënë informacione dhe shpjegime në lidhje me sipërfaqen aktuale të pronës ku ndodhet Teatri Kombëtar, ndryshimet që ka pësuar ndër vite, mënyrën e tjetërsimit të pronave rreth saj, si dhe pronarët kufitarë të pronës së Teatrit Kombëtar.

Zoti Pjetri, ju kemi dërguar disa shkresa, ku ju kërkohet në mënyrë specifike informacion. Është një grup deputetësh i opozitës që ka kërkuar: e para, hartën e zonës, të cilën nuk na e keni vënë në dispozicion, pavarësisht se ka qenë e cilësuar dhe me bold. Pra, ju nuk e keni sjellë hartën e pronësisë. Tani që ne flasim, ju refuzoni t’i jepni Kuvendit, në shkelje kushtetuese dhe ligjore, jam e sigurt me urdhër nga lart, informacionin që ju kemi kërkuar.

Gjithashtu, informacioni që ju na keni sjellë ka pjesërisht lidhje me kërkesat specifike që ne kemi bërë në shkresat që ju kemi dërguar. Ju lutem, a mund të na thoni se cili nen, cila dispozitë ligjore ju ndalon ju të sillni informacionin e kërkuar, bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin për statusin e deputetit, të dërguar me shkresë zyrtare? Cila dispozitë ligjore ju ndalon ju të sillni këtu një informacion?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Do t’ju lutem që ne të lejojmë një herë kryeregjistruesin të flasë, pastaj t’i bëjmë pyetje. Ju e orientoni atë në një drejtim që ju intereson juve. Ndërkohë, opinionin publik ka interes të dëgjojë si është e vërteta. E vërteta nuk është e pjesshme, as fragmentare, por duhet të shikohet e gjithë tabloja që opinionin të gjykojë. Kështu që, ju lutem, lëreni të flasë kryeregjistruesin, të thotë atë për të cilën është thirrur, pastaj të bëjmë pyetjet dhe komentet tona, atë luftën patriotike që bëjmë zakonisht.

Albana Vokshi – Nuk kemi luftë këtu. Këtu do të bëjmë transparencë. Pra, e keni kuptuar gabim se ne jemi këtu për të bërë luftë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu duhen bërë të gjitha. Ju lutem, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Unë preferoj drejtimin e zotit Pollo që ka etikë, kulturë dhe opinionin publik...

Albana Vokshi – E keni bërë aq bajate këtë, sa e përdorni në mënyrë të rëndomtë.

Zoti Pollo ja ku është. Jemi për çështje të tjera.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të lutem, këtu jemi për çështje të tjera. Opozitën nuk e zgjidhni dot. Zoti Baraj e bëri qëllimisht sot, sepse këtë detyrë i kanë dhënë.

Zoti Pjetri, kemi kërkuar një informacion të detajuar, bazuar edhe në një ligj, i cili kaloi në datën 5 korrik me 74 votat e maxhorancës. Bazuar në këtë ligj, ne kemi për detyrë dhe përgjegjësi të bëjmë transparencë për sa i përket pronësisë, shkëmbimeve të pronësisë publike, private në zonën e Teatrit dhe në zonën përreth tij. Kemi kërkuar informacion dhe na keni kthyer përgjigje për një pjesë të informacionit. Për sa u përket privatëve, ju nuk do të na e dërgoni atë. Më thoni se në cilën dispozitë ligjore bazoheni që refuzoni t'i jepni informacion këtij komisioni. Është shumë e thjeshtë dhe kjo besoj se sqaron edhe zotin Baraj.

Valdrin Pjetri – Përshëndetje të gjithëve!

Zonja Kryetare, dua t'ju sqaroj që në datat 9 dhe 10 ka ardhur në zyrën time kërkesa për informacion dhe më është kërkuar të paraqitem në komision në datën 11, por koha në dispozicion ishte shumë e shkurtër, 24 orë, për të përgatitur informacionin për këtë komision, kështu që mora edhe 2-3 ditë të tjera kohë dhe jam sot para komisionit, për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve që ju keni sjellë me shkresën tuaj zyrtare.

Po filloj me pyetjen e parë, ku ju kërkon informacion për...

Albana Vokshi – Një sekondë, sepse nuk keni sjellë hartën. Ku është harta?

Valdrin Pjetri – A mund t'ju përgjigjem?

Albana Vokshi – Së pari, ne kemi kërkuar sipërfaqen aktuale të regjistruar në pronësi të Teatrit Kombëtar.

Së dyti, pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme, ku ndodhet godina e Teatrit Kombëtar dhe sipërfaqen totale, që është në pronësi apo në përdorim të tij.

Së treti, ndryshimet që ka pësuar ndër vite pasuria e paluajtshme, që është shitur për të ndërtuar Teatrin Kombëtar apo për t'u përdorur si teatër kombëtar, duke iu referuar kontratës fillestare të shitjes, bashkëlidhur një kopje, ku thuhet: "Pasuritë e paluajtshme, që kufizojnë pasurinë e paluajtshme në pronësi të Teatrit Kombëtar, mënyrën e tjetërsimit të pronave rreth saj apo ndryshimi i pronësisë që ka ndodhur gjatë periudhës 1992-2018 dhe pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme kufitare".

Së fundi, gjendja aktuale e pronësisë së pasurive të paluajtshme, që përfshihen brenda zonës kadastrale 8150, të ndara sipas pronarëve respektivë.

Cila prej këtyre pikave, që ne kemi kërkuar, nuk duhet t'i jepet si informacion Kuvendit, këtij komisioni dhe në bazë të cilës dispozitë ligjore?

Valdrin Pjetri – Këtij komisioni dhe këtyre pyetjeve unë u jam përgjigjur në mënyrë analitike. Po ta shikoni shkresën zyrtare, që unë solla sot, çdo pyetje juaja ka përgjigjen aty.

Lidhur me pyetjen e parë, pronësia e Teatrit Kombëtar është një objekt në administrim të Teatrit Kombëtar me sipërfaqe 5522,7 metra katrorë truall dhe 1126 metra katrorë objekt në pronësi të shtetit.

Përgjigjja e pyetjes së dytë lidhur me pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme të Teatrit Kombëtar është kjo: duke iu referuar përgjigjes së parë, ku theksojmë se pronësia është shtet sipas kartelës së pasurisë 1/241, volumni 30, faqja 40. Kartelën e pasurisë, që ju keni kërkuar, e keni bashkëngjitur informacionit.

Albana Vokshi – Nuk është, nuk ua keni dërguar deputetëve, e keni sjellë në një zarf tani. Ku e ke?

Valdrin Pjetri - Kartela e pasurisë është bardh e zi, nëse deputetët nuk e kanë, mund ta fotokopjojnë sekretarja dhe t'ua shpërndajë.

Për sa i përket pyetjes lidhur me pasurinë e paluajtshme, që është shitur dhe është ndërtuar Teatrit Kombëtar, zonja kryetare, dua t'ju sqaroj se bashkëngjitur kësaj shkrese nuk kishte një kontratë të përbashkët, megjithatë, unë kam nxjerrë nga regjistrat hipotekorë dhe ju bëj me dije se, referuar regjistrat hipotekor me numër 28, numër rendor 811, datë 09.11.1928, është bërë regjistrimi i një prone me sipërfaqe 10, 625.31 metra katrorë, në favor të mbretërisë italiane, pronë, që i është blerë familjes Libohova, banues në Tiranë, në bazë të aktit publik me numër 22405, të repertorit datë 03.11.1938, akt i mbajtur në prani të noterit Muntaz Kokalari. Në nenin 2 të kësaj kontratë shitblerje thuhet në mënyrë të qartë: “Shkëlqesia e tij, Francesco Jacomoni deklaroi se blen dhe merr në dorëzim pronën në fjalë, në emër dhe për llogari të mbretërisë italiane”.

Për sa i përket pyetjes 4, informacionit që ju kërkon për pikën kufitare të Teatrit Kombëtar, ju sqaroj se ZQRPP-ja mund të paraqesë informacion vetëm për pasuritë me pronar shtet dhe në pronësi të institucioneve publike.

Për sa u përket pasurive private, informacioni është i garantuar me ligj dhe mund të jepet vetëm me kërkesë të pronarit ose institucioneve të ngarkuara me ligj për marrjen e këtij

informacioni. Prandaj, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 35, pika 1, përcaktohet qartë: “Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij”.

Sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në nenin 6, pika 1, përcaktohet se të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin e tij”, pastaj kalojmë te ligji organik, nga i cili ne jemi krijuar dhe funksionojmë si zyrë qendrore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Në ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 65 “Garantimi i informacionit”, pika 1, përcaktohet se “

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme garanton informacion pas përfundimit të regjistrimit fillestar lidhur me të drejtën e pronësisë dhe të drejtat e tjera reale të regjistruara; pasuritë e identifikuar si objekt i këtyre të drejtave dhe mbajtësin e këtyre të drejtave”.

Në vitin 2004, pasuria në fjalë ka përfunduar regjistrimin fillestar, që është faza e parë kur pasuria kalon në sistem. Nga ky moment e tutje, sipas ligjit tonë nr.33/2012, jemi të detyruar të garantojmë informacionin për mbajtësin e të drejtës së pronësisë.

Në këtë kopje janë të gjitha pasuritë shtet, sipërfaqet respektive dhe në pronësi administrative të kujt janë, qoftë të pushtetit vendor qendror, apo pasuri shtet.

Për sa i përket pyetjes 5, ju kërkoni të gjithë informacionin për zyrën kadastrale 8150. Zonja kryetare, ju bëj me dije se zona kadastrale 8150, ka 14750 pasuri shtet dhe neve na duhen 3-4 ditë kohë për të bërë një informacion, ndërsa për pasuri joshtet ka një sipërfaqe totale 104 hektarë. Zyra qendrore në përgjigje të shkresës tuaj ka përgatitur informacion vetëm për pjesën që ju intereson juve, sepse, siç citohet në shkresën tuaj, pjesë e interesit është pasuria e Teatrit Kombëtar, sipas kartelës së pasurisë 1/241, ku në përshkrim të veçantë thuhet Teatri Kombëtar, pasuri shtet. Këtë kopje jua kam sjellë në cilësinë e detyrës time.

Faleminderit!

Albana Vokshi –Faleminderit!

Së pari, citimet që bëni në ligj nuk janë të sakta, sepse nuk i referohen fare informacionit që kërkohet. Ne jemi deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe jemi të ngarkuar me përgjegjësi që të bëjmë transparencë dhe po bazohemi në një ligj specifik, i cili është miratuar me votat e maxhorancës në datën 5 korrik. Pra, të dhënat ne po i kërkojmë në bazë të këtij ligji, sepse në bazë

të ligjit do të ketë ndërveprime dhe tjetërsime të pronës publike në bashkëpunim me pronën private. Ju, zoti kryeregjistrues, nuk keni asnjë tagër që t’i refuzoni këtij komisioni dhe deputetëve të parlamentit informacionin e kërkuar.

Gjithashtu, më lejoni që të bazohem edhe në disa dispozita të tjera ligjore.

Së pari, neni 18, pika 3 e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, thotë: “Kontrolluesi nuk është i detyruar të japë informacion dhe të informojë për rastet kur të dhënat personale nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave, nëse ai detyrohet të kryejë përpunimin e të dhënave personale në bazë të një parashikimi ligjor”. Kjo do të thotë se kontrolluesi, ZRPP-ja, kur vepron në përmbushje të detyrimit ligjor, nuk është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave për të marrë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave personale. Në rastin konkret, detyrimi buron nga ligji “Për statusin e deputetit” dhe ZRPP-ja është e detyruar ta ofrojë këtë informacion, pa qenë e detyruar të informojë paraprakisht subjektin. Në bazë të ligjit, nëse duhet, ne mund të bëjmë përpunimin e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit, por ju nuk mund të refuzoni, ashtu sikurse ju kanë urdhëruar që të refuzoni informacionin.

Së dyti, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin, që sapo citova më lart, të cilin për shkurt po e quaj ligji “Fusha”, ku parashikohet bashkëpunim i privatit me shtetin, ku privati jep dhe merr me shtetin. Në këtë kuadër, informacioni për të dhënat e pronësisë së privatit janë të detyrueshme për t’u dhënë nga ZRPP-ja, për shkak se janë të domosdoshme për përmbushjen e funksionit kushtetues. Detyrimi ynë është që ne të ruajmë konfidencialitetin. Pra, ju po shkelni Kushtetutën dhe një sërë ligjesh. Atëherë, pse ju refuzoni të jepni informacion se sa është sipërfaqja e të gjithë privatëve që janë kufitarë, edhe në zonën që i përket ligjit “Fusha”? Ju lutem, sa është sipërfaqja e privatëve?

Valdrin Pjetri – Jua them unë direkt. Ju thoni se ZRPP-ja është organ kontrollues, por nuk është ashtu, ZRPP-ja është zyra ku depozitohen aktet dhe merret titulli i pronësisë. Pra, që këtu bie poshtë ajo që thoni ju.

Albana Vokshi – Kush e tha këtë?

Valdrin Pjetri – Ju e thatë dhe iu referuat ligjit për të dhënat personale.

Albana Vokshi – Unë lexova dispozitën ligjore. Mos më ndryshoni fjalën!

Valdrin Pjetri – Po të shikojmë ligjin për të dhënat personale, nenin 6, “Kriteret ligjore për përpunimin”, të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin.

Albana Vokshi- Lexo më poshtë germën “b”, sepse ju kanë orientuar gabim. Nuk mund të ndaleni vetëm aty, ku ju kanë orientuar.

Valdrin Pjetri – Për sa i përket qëndrimit tonë dhe pyetjes tuaj se kush na ka penguar, zonja kryetare, ne na ka penguar Kushtetuta e Shqipërisë. Po jua ricitoj nenin 35 të Kushtetutës: “Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhënat që lidhen me personin e tij”.

Albana Vokshi –Atëherë, e kërkon ligji që ka miratuar maxhoranca. Ligji “Fusha” kërkon që të zbardhet pronësia. Pra, ju prapë po bini me të dyja këmbët brenda. Kushtetua detyron transparencë për çdo ligj që kalohet në Kuvend dhe ne jemi të vendosur të bëjmë transparencë. Ju lutem, zoti kryeregjistrues, bëni detyrën tuaj dhe mos u bëni palë, dilni përtej interesave!

Valdrin Pjetri – Unë përfaqësoj Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Albana Vokshi – Jeni të detyruar.

Valdrin Pjetri - *...(nuk dëgjohet)* ligjit tonë organik nr.33/2012, nga i cili jemi krijuar dhe funksionojmë. Pra, në momentin që bëhet regjistrimi fillestar i pasurisë, pra kur zona e qendrës, të cilës ju i referoheni, bëhet pasuri e Teatrit Kombëtar, në vitin 2004, atëherë ka përfunduar regjistrimi fillestar. Nga momenti që bëhet regjistrimi fillestar, sipas ligjit tone, neni 65, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme garantojnë informacionin pas përfundimit të procesit fillestar, i cili lidhet me të drejtën e pronësisë dhe të drejtat reale të regjistruara, pasurinë e identifikuar si objekt i këtyre të drejtave dhe mbajtësin e kësaj të drejte. Unë i kam cituar edhe në shkresën time zyrtare, kam printuar një kopje të Kushtetutës dhe të akteve ligjore. Ky është qëndrimi i zyrës sonë.

Albana Vokshi – Atëherë, kontrolluesi, sipas ligjit, është çdo person që administron të dhëna, e tillë është edhe ZRPP-ja. E kërkon ligji dhe Kushtetuta që ju të jepni informacion, qoftë për pronën publike të ligjit “Fusha”, që sapo është miratuar nga maxhoranca, qoftë për pronën private. Ne jemi të interesuar të dimë sa metra katrorë sipërfaqe ka kompania “Fusha”. Sa metra katrorë sipërfaqe kanë pronarët e tjerë në atë zonë? Sa sipërfaqe ka bashkia? Ju nuk keni informuar për sipërfaqen që ka bashkia dhe vini këtu dhe thoni që ka rreth 4500 prona.

Valdrin Pjetri – Kryetare, e kemi dhënë këtë informacion.

Albana Vokshi – Jo, nuk e keni dhënë. Nuk më intereson godina, do të shembni edhe godinën e bashkisë.

Valdrin Pjetri – Ne japim informacion për truallin dhe ndërtesën.

Albana Vokshi – Zotëri, ju nuk keni dhënë sa...

Valdrin Pjetri – E doni informacionin për Bashkinë e Tiranës?! Po jua jap direkt.

Albana Vokshi- Duhet ta kishit sjellë.

Valdrin Pjetri – Është këtu.

Albana Vokshi – Keni sjellë vetëm godinën e bashkisë. Sa metra katrorë ka bashkia nën ligjin “Fusha”?

Valdrin Pjetri – *(nuk dëgjohej)*.... Prandaj, edhe për Bashkinë Tiranë dhe çdo institucion tjetër shtetëror, që ndodhet aty, e keni informacionin në kartelën e pasurive.

Albana Vokshi- Atëherë, po ju pyes: sa metër katrorë ka bashkia në territorin që do të ndërtohet dhe sa metër katrorë ka privati?

Valdrin Pjetri – Për sa i përket informacionit për pasuri shtet, do të filloj dhe të citoj shkresën time.

Albana Vokshi- Nuk dua shtetin, por bashkinë dhe privatin. Dua të di sa privatë janë, sa sipërfaqe kanë dhe sa sipërfaqe ka “Fusha”. Kaq duam të dimë ne.

Valdrin Pjetri – Zonja kryetare, e keni informacionin këtu së bashku me kartelën e pasurive, përfshirë edhe Bashkinë Tiranë. Ky është informacion për çdo pasuri shtet dhe përqark Teatrit Kombëtar. Po të bëjmë mbledhjen e këtyre të dhënave, del informacioni zyrtar se sa është pasuri shtet.

Albana Vokshi- Zotëri, unë po ju pyes për bashkinë, jo për shtetin, sepse shteti nuk duhet të ekzistojë dhe për këtë keni shkelur ligjin. Më thoni, ju lutem, sa sipërfaqe ka Bashkia Tiranë në të gjithë zonën që ne jemi të interesuar?

Valdrin Pjetri – Duhet bërë mbledhja e informacionit, që unë ju kam dërguar zyrtarisht, dhe aty keni të gjitha pasuritë shtet.

Albana Vokshi – Jo shtet, por Bashkia Tiranë. Shteti pa një institucion nuk duhet të ekzistojë. Ju po thoni që shteti do t’i kalojë bashkisë?

Valdrin Pjetri – Menjëherë që del një titull pronësie, qoftë kontratë shitjeje, qoftë vendim i Këshillit të Ministrave, për kalim të drejtash, regjistrohet në hipotekën e Tiranës dhe atje mund t’ju japin informacionin që ju kërkoni. Ndaj rezulton shtet pasuria.

E thashë edhe më parë, për sa kohë nuk ka një VKM ose VKM-ja nuk ka ardhur për regjistrim pranë zyrave tona, pasuria rezulton shtet dhe këtë e keni në informacionin që ju kam sjellë. Këtu citohen në metra katrorë të gjitha sipërfaqet shtet.

Albana Vokshi - Zotëri, nëse nuk e dini, më mirë heshtni. Unë dua të di sa është sipërfaqja totale e Bashkisë Tiranë në të gjithë zonën, për të cilën ne jemi të interesuar dhe i përket ligjit "Fusha", që është 8500 metra katrorë?

Valdrin Pjetri – Për sa i përket pronësisë shtet, ajo është 2100 metra katrorë. Këto janë shifra të mbledhura nga materiali që keni në tryezën tuaj.

Albana Vokshi –Shtet nuk do të thotë bashki, sepse po bëni një gafë të madhe. Unë dua sipërfaqen tani, jo ajo që do të jetë.

Valdrin Pjetri –Kryetare, e keni informacionin mbi tavolinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi –Po gaboni rëndë. Unë dua të di sa sipërfaqe ka Bashkia Tiranë? Nga mbledhja që bëtë ju doli 2100 metra katrorë, aq sa metrat katrorë të Erion Veliaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur të bëhesh kryeregjistrues ti dhe të vjedhësh ca prona, atëherë do të të pyes ty. Hesht të lutem!

Sa sipërfaqe katrorë ka kompania "Fusha"?

Valdrin Pjetri – Nuk e di sa ka kompania "Fusha", por unë këtu kam cituar të gjitha pasuritë shtet.

Albana Vokshi – Ju nuk mund të flisni atë që keni në mendje. Pse refuzoni të jepni informacionin se sa metra katrorë ka kompania "Fusha" dhe sa privatë janë aty?

Valdrin Pjetri – Objekti i kërkesës tuaj është Teatri Kombëtar.

Albana Vokshi – Zona përreth Teatrit Kombëtar. Po gaboni rëndë. Ju lutem, mos u përdorni!

Valdrin Pjetri –Teatri Kombëtar ka 5522 metra katrorë. Pasuria 1/240 me sipërfaqe 137 metra katrorë...

Albana Vokshi – Zoti kryeregjistrues, nuk jua kam dhënë fjalën. Duam të dimë sa ka kompania "Fusha", jo shteti. Pse e fshihni se sa metra katrorë ka kompania "Fusha"? Mos u bëni vegël për të fshehur këtë vjedhje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi –A ka mundësi të flasim, se jemi në komision?

Zoti Pjetri, këtu je para një komisioni parlamentar, që do të thotë se je para një komisioni me përmbajtje politike. Kërkesa jonë, pavarësisht anës teknike, kërkon fakte mbi bazën e

argumenteve politike dhe gjuha që ke përdorur ti në dokumentacionin e sjellë, quhet gjuhë topografike dhe ka nevojë për fjalor. Fjalori i kësaj është ajo që të kërkoj kryetarja në fillim, hartën. Si mund të flasësh ti këtu pa hartë dhe lexon: “Zona nr.13/65”, dhe unë duhet të zhvilloj fantazinë time, të kapërcej male e kodra dhe të vij tek Teatri Kombëtar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Beqaj, ule atë fletën, se po flas unë!

Zoti kryeregjistrues, nëpërmjet medias, opinioni publik kërkon të dijë me hartë se ku është sipërfaqja e Teatrit Kombëtar, që quhet truall, ku është objekti, sepse unë mund t’ju pyes “a e fusni zdrukthëtarinë tek ajo sipërfaqe?”. Ti mund të thuash që nuk e di. Po Teatrin Eksperimental e fut tek ajo sipërfaqe?! Jo, sepse ti përgjigjesh vetëm me numër pasurie, por nuk ke të drejtë, sepse duhet të kishe hartën që të tregonte qartë gjurmën e Teatrit Kombëtar, gjurmën e truallit, gjurmën e objektit dhe më pas...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...dhe në argumentet tuaja ju thoni se nuk i jepni të dhënat për pronë private, sepse ruani të dhënat personale. Ne kemi kërkuar se cila është prona e privatit dhe ti, për të ruajtur të dhënat konfidenciale, sipas parimit juridik për të dhënat konfidenciale, mund të thoshe: “Privati nr.1 ka kaq sipërfaqe, prona shtet është kaq dhe raporti midis këtyre pronave është i tillë”. Këtë kemi kërkuar ne të shoqëruar me hartë, por ti zhytesh në thellësi thjesht për të bërë kakofoni, për të bërë rrëmujë dhe për të fshehur informacionin.

Kryetarja e tha shumë qartë, që baza e këtij diskutimi sot është ligji “Fusha”, sepse kështu quhet. Vetë zoti Fusha e ka dhënë pëlqimin e tij për pronën e tij, si mund të dalësh ti dhe ta mbrosh?! Në parlament është thënë se zoti Fusha do të zhvillojë atë pronë në atë territor, sepse ka një sipërfaqe në dispozicionin e tij. Por ku mund ta marrë këtë informacion opinioni publik, në qoftë se nuk e jepni ju, si kryeregjistrues?! Çfarë është kjo e dhënë konfidenciale?! Pse keni frikë ta përmendni?! Në këtë komision është dhënë edhe sipërfaqja, 1200 metra katrorë, dhe ju vazhdoni ta quani “të dhënë konfidenciale”. Si ka mundësi që bëhet një ligj mbi bazën e një pretendimi pronësor të një subjekti, që e ka pranuar publikisht t’i dalë e dhëna, dhe ju thoni që është sekret shtetëror?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi –Çfarë do të negociohet?! Toka do të jepet.

Luçiano Boçi – Edhe një herë tjetër. Thirrja juaj para komisionit ka kontekst shumë të thjeshtë, pa u zgjeruar në gjëra të tjera, vetëm sa sipërfaqe ka kompania “Fusha”, që pretendohet të kalojë në përdorim privat një sipërfaqe prej 8500-9000 mijë metrash. Sa është pjesa e teatrit? Sa është pjesa e ndërtesës? Pra, i bëme këto pyetje për t’i bërë transparente këto të dhëna, meqenëse ajo gozhda e Nastradinit, ku vari xhaketën “Fusha”, është sipërfaqja, që tha: “Ma ka lënë babi këtu dhe gozhdën”, apo jo? Meqenëse ia ka lënë gozhdën, do të varë pak xhaketën, do të bëjë 6 kulla! Edhe një herë, po kërkoj, në emër të komisionit dhe të thirrjes tënde, sa është sipërfaqja që do të marrë kompania “Fusha”? Kjo është thembra e Akilit, e debatit parlamentar, e vorbullës, protestës e të tjera. Ju vini këtu dhe thoni numra, numra pa hartë. Vini këtu dhe bëni rrëmujë, pasuria filan e të tjera. Jepini të dhënat e sakta, sepse nuk jeni këtu për të treguar numrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Urdhëroni!

Ju lutem, me qetësi!

Zoti Beqaj, jeni shumë nervoz, po ndërhyini në çdo moment. Sa herë ka koncesion apo shuma të mëdha parash, ju përfshihen në debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kuptoj që është si përkëdhelje, sepse me 400 e ca milionë, që i ke dhënë koncesione shëndetësie, këto të duken...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, sepse jeni duke prishur mbledhjen!

Ilir Beqaj - Zonja kryetare, kemi një kërkesë të bërë nga ju, ku kërkon kartelën e pasurisë së paluajtshme. Për këtë kam edhe një përgjigje për ju, zoti Boçi...

Luçiano Boçi – Zoti Beqaj, jep përgjigje për kohën kur ishit ministër Shëndetësie, mos jepni përgjigje për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Beqaj, ke shumë përgjigje për të dhënë, ke *check up-in* dhe shumë gjëra të tjera. Prandaj lëre atë të flasë vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ja ku e ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Nuk është shpërndarë materiali, e solli me vete.

Albana Vokshi – Më lër ta shpjegoj, se zoti Beqaj do që të bëjë rrëmuje.

Ilir Beqaj – Ky është formati i kartelës që ka shteti shqiptar. Nuk mund ta sjellë kryeregjistruesi, kushdo qoftë; kjo është e miratuar me vendim qeverie.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk mund të vijë pa hartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është ligji “Beqaj”, është ligji “Fusha”, prandaj, të lutem, na lër!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora, nuk do që të përgjigjet sa sipërfaqe ka kompania “Fusha”.

Ilir Beqaj - Nuk e ke kërkuar, prandaj nuk ta ka sjellë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem!

Jemi shumë të interesuar të bëjmë transparencë. Kështu që pa gjaknxehtësi dhe pa nervozizmin që po mundohen ta përcjellin të ardhurit rishtas sot. Zoti Beqaj, ja ku i keni pyetjet, i kanë bërë deputetët; nëse nuk i keni, merrini, lexojini.

Të lutem, mos ndërhyini!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ajo është bashkangjitur tani, shikoje ku e ke. Pika e fundit: “Gjendja aktuale e pronësisë së pasurive të paluajtshme, që përfshihen brenda zonës kadastrale nr. 81/50, të ndara sipas pronarëve respektivë”. Është shumë e qartë, zoti Beqaj, ja ku e ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Beqaj, ju lutem, mos prishni mbledhjen! Ja ku e keni, pika e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk keni sjellë asgjë për pikën e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, mbylleni!

Nuk do të sjellë asgjë, është urdhëruar të mos sjellë asgjë. Ju këtë e kuptoni. Ju lutem, për pikën e fundit që kemi kërkuar ju, në prezantimin tuaj, thatë: “Ka rreth 14 mijë e 700”. Atëherë, pse nuk i keni sjellë? T’i sillni të gjitha, sepse duhet t’i kemi ne. I kemi kërkuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, mos e merr fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Zonja kryetare, po kërkoni gjëra që nuk mund të kërkohen.

Albana Vokshi - Unë e di shumë mirë se çfarë kërkoj dhe ne e dimë shumë mirë se çfarë kërkojmë; ju nuk e dini se ku po e çoni veten. Ky është problem shumë i madh, sepse jo vetëm këta, që janë bërë shërbëtorë dhe vetëm ngrenë kartonin, por, për fat të keq, po bëheni edhe ju, në variantin më të mirë, po ju shtrëngojnë të bëheni edhe ju palë. Po refuzoni që të përgjigjeni sa ka kompania “Fusha” dhe sa kanë privatët. Harta duhet të vinte e bashkangjitur. Vetëm më keni sjellë një kopje dorazi dhe në momentin që filluam, asnjë nga deputetët firmëtarë nuk kanë asnjë informacion për kartelat. Edhe ky informacion është i mangët, në shkelje të Kushtetutës. Ju, në shkelje të Kushtetutës, po refuzoni që të jepni informacion. Nëse ju duhet kohë, ta mbyllim mbledhjen, t’ju lëmë gjysmë ore kohë, dhe hajdeni pas gjysmë ore. Bëni edhe ato llogaritë 2100 të bashkisë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Luçiano Boçi - Nuk i ka sjellë informacionet, sepse i solli në mëngjes me vete.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Beqaj, e pranuat që nuk i ka sjellë informacionet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk sillet në mëngjes, sepse merret informacioni, lexohet dhe konsultohet. Pse, tani që filloi mbledhja merret informacioni?

Albana Vokshi – E dimë që ti i kupton shumë mirë, na lërë ta kuptojmë edhe ne. Nuk jemi marrë ne me pazare, siç jeni marrë ju. Kështu që, ne që nuk jemi marrë, na lini që t’i kuptojmë rehat. Ne duam të kuptojmë “Fushën”! Nëse ju e dini si është “Fusha”, na e shpjegoni, që ta marrin vesh të gjithë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Urdhëroni, zonja Mehmetaj!

Kejdi Mehmetaj – Zoti kryeregjistrues, dua t’ju sjell edhe një herë në vëmendjen tuaj se refuzimi i dhënies së informacionit që kërkon komisioni apo parlamenti, bashkangjitur me të mos qenit i vërtetë, nuk po përdor fjalët as mashtrim dhe as gënjeshtër, sepse për detyrën që mbani nuk ju shkojnë fjalimet politike, pra në rast se ju refuzoni të jepni të dhënat ose të shkelni detyrën tuaj,

duke mos qenë i vërtet në këtë komision, ju mbani përgjegjësi ligjore për shpërdorim detyre. Po jua theksoj këtë, që kur të jepni përgjigjet në vazhdim, të keni parasysh edhe këtë pjesë të ligjit, përpara se të flisni.

Së pari, ju, kur filloi mbledhja, thatë se ju është dashur një kohë shumë e gjatë që të përgatisni materialin. Sa për informacion të qytetarëve, mjafton një klikim në sistemin që ka hipoteka për të nxjerrë të gjithë informacionin. Pra, me një klikim si për të gjitha pronat që do të ishin pjesë e asaj zone kadastrale, do të mjaftonin më pak sesa 1 apo 2 orë për të sjellë të gjithë informacionet që neve na nevojitet. Ndërkohë, ju keni marrë shumë ditë dhe sot nuk keni arritur të na i sillni në kohë, t'i depozitoni në kohë, as këtë material me shkrim që e keni sjellë, që nuk ka asnjë përgjigje të pyetjeve që ne kemi kërkuar dhe as kartelën që duhet të na e sillnit. Sa për informacion, edhe një qytetari të vetëm kur kërkon informacion për pronën e tij, bashkëngjitur me atë kartelën që ju na dhatë, që ne nuk e kemi, i jepet edhe harta e pronës. Kjo është shumë, zoti kryeregjistrues, dhe nuk mund të thoni se nuk është kështu. Siç ju ua jepni qytetarëve, ashtu duhet të na i jepni edhe ne, sepse është e njëjta kërkesë, pavarësisht se kush e kërkon atë. Pra, ju nuk mund të fshiheni pas atyre që ju i konsideroni si të vërteta.

Pra, kemi këto gjëra në dorë deri tani:

Së pari, detyrimin tuaj të mundshëm për të na sjellë shumë më parë informacionin që kërkuam.

Së dyti, bashkëngjitur kartelës patjetër duhet të ishte dhe harta.

Po kaloj te pyetjet që ne ju kemi bërë. Në përgjigjen tuaj, ju keni thënë se kur është regjistruar fillimisht prona, kanë qenë rreth 10 mijë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Siç rezulton në regjistrat tuaj, kjo ka qenë pronë publike deri në një moment të caktuar. Ne kërkuam të dinim: çfarë ka ndodhur me atë pronë, që ka qenë publike deri në momentin e caktuar, pronë e mbretërisë, që pastaj i kaloi shtetit shqiptar? Çfarë ka ndodhur? Si është ndarë prona? Ku ka shkuar prona? Si është tjetërsuar prona? Ju nuk mund të fshiheni këtu pas mbrojtjes së të dhënave personale. Kur një pronë publike, ka shkuar te privati, pa dyshim që aty ka një gjurmë, që është publike, dhe ne duhet të na vihet në dispozicion edhe pa u fshehur pas mbrojtjes së të dhënave personale. Pse nuk e kemi sot atë informacion? Ju lutem, a mund të na e dorëzoni atë informacion?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem, mos ndërhyini, sepse ka një procedurë!

Të lutem, këtë nuk e ka Rregullorja!

Ismet Beqiraj – Albana, të lutem, ndaj pyetjet nga diskutimet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luciano Boçi – Ismet, lëre, sepse e ka parashtrim ajo, do të bëjë edhe pyetje.

Albana Vokshi – Nuk keni ardhur këtu as për pyetje, as për diskutime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Zonja kryetare, të lutem, ndaj pyetjet nga diskutimet.

Albana Vokshi – Ismet, të lutem, mbylleni dhe mos e merrni më fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Ju keni një detyrim, që të na vini dhe të na jepni informacionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ismet, nuk e merr dot ti mikrofonin ashtu!

Ismet Beqiraj – Kryeregjistruesi po përgjigjet në mënyrë korrekte për të gjitha pyetjet që ka bërë grupi juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mos e merr më fjalën pa ta dhënë unë. E dimë që nervozoheni, sepse ju kanë thënë. Nuk e merr dot mikrofonin!

Fjalën e ka zonja Mehmetaj. Ki respekt për kolegen. E dimë që po i hapen petët lakrorit dhe kjo ju ka shqetësuar, por do të bëjmë transparencë, do të marrim kohën e duhur.

Ismet Beqiraj – Le t’i hapen petët lakrorit dhe byrekut, po deshe!

Albana Vokshi – Të lutem, respekt për kolegen!

Kejdi Mehmetaj – Ju e keni detyrim të na jepni përgjigje për pyetjet që ne kemi shtruar.

Kam një tjetër pyetje. Besoj se qeveria përpara se të na sillte ligjin “Fusha” në parlament, ka kërkuar një informacion zyrtar nga ana juaj, besoj se edhe bashkia duhet ta ketë kërkuar përpara se të bënte një shkëmbim të pronës me vendim të këshillit bashkiak, pak a shumë të njëjtat pyetje që kemi shtruar edhe ne. Pyetja ime është: a ju është kërkuar informacion zyrtar nga ana e qeverisë dhe nga ana e bashkisë së Tiranës lidhur me pronën mbi të cilën ndodhet Teatri Kombëtar dhe rreth e rrotull tij?

Nga ana tjetër, informacioni që ju keni dhënë, është i njëjtë me atë që na keni dhënë ne, apo është i ndryshëm? Nëse është i ndryshëm, ju lutem, na e vini në dispozicion; nëse është i njëjtë, kemi tri institucione që duhet të përballen me drejtësinë: së pari, ju, për informacionin jo të saktë

që keni dhënë; së dyti, bashkia dhe qeveria, sepse në relacionin që ne na kanë bashkangjitur thuhet se në Tiranë ka rreth 2 mijë e 100 metra katrorë pronë bashkie, ndërkohë në këtë informacion që ju na keni sjellë me titull “Bashkia Tiranë” ka vetëm 801 metra katrorë pronë publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po i referohem kësaj që kanë dërguar këtu. Ndërkohë, të gjitha sipërfaqet e tjera janë “shtet” të ministrive të tjera. Pra, arritëm në përfundimin që për të ndërtuar ato kullat atje “Fusha”, “Rama”, “Mali”, kushdo qoftë pas tyre, në fakt, ajo që po merr si pronë janë oborret e institucioneve tona shtetërore. Pra, ky është konkluzioni që del nga informacionet që ju na keni dhënë.

Së fundi, ju lutem edhe një herë, i bashkëngjitem kërkesës që bënë kolegët e mi, për të na dhënë një informacion të plotë dhe shterues për pronat që ndodhen rreth e rrotull Teatrit Kombëtar, përfshirë ato shtetërore dhe private. Nëse ju keni problem pjesëmarrjen e kamerave këtu, ne si komision, të paktën unë e bëj propozim edhe për kolegët e LSI-së) jemi të gatshëm të mbyllim seancën me kamera, le të dalin, nuk kanë problem...

Albana Vokshi – Ne shyqyr që po i tregojmë publikut, sepse po të jetë për këta, këta i shembnin natën dhe nuk merr vesh gjë.

Kejdi Mehmetaj – Nëse këtu ka një problem për ruajtjen e sekretit, ne jemi të gatshëm të bëjmë edhe një seancë tjetër, por të jetë i sigurt qytetari se as atë seancë nuk do ta pranojnë, sepse, në fakt, thjesht duan të fshehin të vërtetën. Ju lutem, ktheni përgjigje për pyetjet që ju bëra!

Albana Vokshi – Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Mua më vjen keq për një gjë, që ne përpiqemi të krijojmë mjegull në opinionin publik, në një kohë që ne kemi bërë një kërkesë shumë të qartë, e cila është e përgjithshme, nuk është e veçantë. Nuk e di, nëse keni shkuar në hipotekë, unë kur kam shkuar para disa ditësh dhe kam marr një certifikatë. Ka një gjë, këtu krijohet iluzioni sikur harta është sekret. Absolutisht, jo. Unë jam i bindur, meqenëse nuk e keni specifikuar këtu, që jeni të interesuar për filan pronar, por keni thënë për pronat në përgjegjësi; zotëria, duke iu referuar numrave kadastralë, e informoi komisionin. Në qoftë se ne...

Luciano Boçi – Sill hartën dhe kjo punë është e sqaruar. Është shumë e thjeshtë.

Besnik Baraj – Sigurisht, është e drejta jonë që të bëjmë edhe kërkesa specifike, që të dalin si rrjedhojë e faktit që pyetjet tona, kërkesat tona nuk kanë qenë shumë specifike. Është normale. Kur dikush bën një kërkesë në diskutime e sipër, del një element tjetër, i cili në kërkesën e parë të

bërë, nuk ka qenë e shprehur qartë. Atëherë, fare mirë, të mbledhim ato kërkesa specifike që dalin këtu, dhe është krejt normale, t'ia adresojmë dhe zotëria një ditë tjetër ose vjen këtu, ose na i dërgon me shkrim dhe në prani të kamerave ju zbuloni enigmën e madhe, që ekzistua në hipotekë. Prandaj, ju lutem, edhe një herë i kërkoj kryeregjistruesit të lexojë para opinionit publik si ka qenë kërkesa e bërë nga ne.

Albana Vokshi – E lexova unë kërkesën. Çfarë të lexojë kryeregjistruesi?!

Besnik Baraj – Për këto kërkesa që po bëjmë ne është krejt normale që ai të mos i ketë me vete, sepse edhe ju po të ishit kryeregjistruese, nuk do i parashikonit të gjitha pyetjet që bën komisioni i nderuar, siç është ky këtu. Kështu që unë kam kërkesë që opinionit publik të marrë një herë informim, si ka qenë e formuluar kërkesa jonë, është e përgjithshme, apo aty flitet se duhet harta?

Albana Vokshi - A e kishe mendjen kur i lexova pyetjet? I lexova nga e para tek e fundit. Nuk e ke pasur mendjen; kjo është për procedurë. Ke pyetje, apo jo?

Besnik Baraj – Të lutem, mos më ndërprisni!

Të gjitha ato që thatë ju, janë të përgjithshme. Të gjitha specifikat e kërkesave tuaja, unë i gjej në përgjigjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Specifikisht 4 pronarët kufitarë, 10 pronarët kufitarë ...

Besnik Baraj - Ju bëni sikur nuk keni qenë këtu, por sikur keni ardhur nga Marsi dhe keni ardhur në një realitet...

Albana Vokshi – Zoti Baraj, për ju kam keqardhje shumë të madhe!

Besnik Baraj - Unë jam i lumtur që ke keqardhje për mua!

Albana Vokshi – Ju, që keni kaq vjet që jetoni në Tiranë, duhet të ishit atje për të mbrojtur teatrin. Mua më vjen shumë keq që edhe ju, që e mbani veten intelektual, jeni rreshtuar, keni mbyllur gojën dhe jeni bërë shërbëtor thjesht për një karrige deputeti. Kjo është fatkeqësi e madhe, sepse ju ka humbur identitetin. Ku kanë mbetur vlerat që keni pasur, aq sa mund të keni pasur dikur?! Jeni bërë rilindës, nuk ka më PS.

Besnik Baraj - Po të mos kishit keqardhje, unë do të ndihesha keq, në qoftë se ju nuk do të kishit keqardhje. Shkoni në Bajram Curi dhe shikoni si është bërë, sepse sapo vij që andej.

Albana Vokshi – Më keq për ju, zoti Baraj!

Të lutem, pyetja është specifike, meqenëse ...

Besnik Baraj - Shikojeni pak si është bërë Valbona.

Luçiano Boçi – Kur të bësh fushatën, thuaji këto, sepse nuk jemi në fushatë këtu.

Albana Vokshi – Do t’i përgjigjeni asaj që them.

Zoti Pjetri, kur t’jua jap fjalën, sepse ka një procedurë.

Po e përsëris pyetjen: sa sipërfaqe katrorë ka secili prej pronarëve kufitarë? Sa sipërfaqe ka kompania “Fusha”? Këtë pyetje bëri edhe Kejdi, këtë pyetje kemi edhe ne, është pika e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Dua të ftoj kamerat të fokusohen pak te kërkesa e kryetares së komisionit.

Albana Vokshi – Zoti Pjetri, do t’ju nxjerr përjashta!

Ju lutem, përgjigjuni!

Ju këtu nuk bëni dot aktrim. Ja ku e keni kërkesën e deputetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk aktroni dot aty. Unë ju them përgjigjuni pyetjes specifike. Kaq! Jo më aktrim aty. Kush janë pronarët kufitarë? Sa metra katrorë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e paskeni lexuar kërkesën. Keni qenë i shqetësuar dhe nuk e keni lexuar.

Të lutem, sa metra katrorë ka “Fusha”? Sa metra katrorë kanë të gjithë kufitarët me teatrin? Këto janë pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Po i përgjigjem zotit Luçiano për sa i përket kartelës së pasurisë...

Albana Vokshi – Zoti Pjetri, meqenëse nuk doni të përgjigjeni, sepse ashtu keni marrë urdhër, po ia kaloj deputetit.

Më thuaj sa metra katrorë ka kompania “Fusha”? Sa metra katrorë ka privati? E keni detyrim kushtetues, neni 80 i Kushtetutës. Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A mund t’i mbledhim të gjitha pyetjet për zotin Pjetri? Zoti Pjetri, të lutem, grumbulloi të gjitha pyetjet e deputetëve dhe përgjigjuni në fund të pyetjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, a mund të vendosim një rregull, sepse kështu nuk bëhet!

Kejdi Mehmetaj – Po, por nuk po na kthen përgjigje.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, duhet t’ia japim fjalën, që të na kthejë përgjigje.

Albana Vokshi – Milva, jo përgjigje sipas qejfit, duhet të japë përgjigje për pyetjet.

Milva Ekonomi – Ai do të japë përgjigje për pyetjet.

Albana Vokshi – Atë shkresën na e ka nxjerrë 100 herë.

Milva Ekonomi - T'i mbledhim të gjitha pyetjet dhe të përgjigjet.

Albana Vokshi – Urdhëroni!

Nora Malaj – Një grup deputetësh ka bërë 7 kërkesa për ZRPP-në, dhe përgjigjet që kemi marrë janë evazive dhe jo të plota.

Zonja kryetare, propozimi im është: nëse kryeregjistruesi, nuk do të na japë informacionin e plotë, propozoj t'i japim shansin të vijë një herë tjetër, sepse kjo nuk është transparencë thjesht për të thënë dhe për të krijuar zhurmë, por e kemi shqetësim, dhe nuk ka arsye pse të mos e japë informacionin. Të mbajë shënim dhe pyetjet dhe të na japë të gjithë informacionin e plotë me shkrim dhe me gojë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ismet, mos ndërhyini, jo me nerva!

Ismet Beqiraj – Nuk është çështje nervash.

Albana Vokshi - Nuk ke pse ndërhyin.

(Zoti Beqiraj flet pa mikrofon.)

Ismet, kini pak respekt!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet, të kanë dhënë urdhër të prishësh mbledhjen, sepse nuk mund të nxjerrë sa ka “Fusha”? Kjo është detyra jote? Të lutem, mos ndërhyini dhe mos bërtisni, sepse ka një procedurë!

Zonja Malaj, propozimi juaj ishte që t'i japim kohë...

Nora Malaj - Të nderuar kolegë, po flasim për t'i dhënë kohë, sepse edhe kryeregjistruesin e kemi tonin, nuk e kemi armik. E kemi vendosur për të bërë një punë për të gjithë shqiptarët. Ajo çfarë është shkruar këtu, nuk është përgjigje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ne jemi firmëtarët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nora, të lutem, propozimin, sepse nuk po merret vesh asgjë!

Nora Malaj – E nderuar zonja kryetare, në mënyrë që të zgjidhim të gjitha gjërat, që të jemi transparentë dhe të mos kërkojmë gjëra të pamundura, unë propozoj, meqenëse informacioni

nuk ka ardhur i plotë, le të bëjmë një takim radhën tjetër, duke e ndihmuar edhe kryeregjistruesin, që të na i japë të plotë të shkruar dhe mbi bazën e saj të realizojmë dhe të bëjmë transparencën që kërkohet. Ky është propozimi im.

Albana Vokshi – Dakord. Është një propozim për procedurë. Atëherë, a jeni dakord që t'i japim disa orë kryeregjistruesit, meqenëse nuk i është përgjigjur asnjë pyetjeje?

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A t'u përgjigjet një herë atyre pyetjeve që janë bërë?

Albana Vokshi – Milva, të lutem!

E dëgjuam kryeregjistruesin që na lexoi këtë informacionin. Të lutem, Milva, ja ku është informacioni; edhe ky është i mangët, sepse mungojnë: 62, 66, 183 dhe 70. Keni dhënë çfarë ju ka dashur qejfi apo çfarë ju kanë thënë për të raportuar? Domethënë, edhe këto shtetëroret, gjysmat i keni vënë dhe gjysmat nuk i keni vënë. Për fatin tuaj të keq, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Do të bëhet transparencë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Pjetri, ju lutem, se po shkelni procedurat e këtij komisioni, madje është e disata herë, mos e merrni fjalën pa jua dhënë unë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull? Kjo është procedura në këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem shumë, mos ndërhyini!

Nuk u keni dhënë asnjë përgjigje të gjitha pyetjeve që ne kemi specifikuar.

Tani në mëngjes, sapo filloi, më keni dhënë dy harta për të cilat unë nuk kam pasur as kohë t'i shikoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk më keni dhënë hartë, më keni dhënë kartelat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faktikisht, ky është libri i ngastrave për secilën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, marrë nga libri i ngastrave. Por asnjëri prej deputetëve nuk i ka, i kam vetëm unë. Hartë nuk keni sjellë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, se po flas!

Nga një *check*-im që u bëra pronave, që ju keni raportuar, janë të mangëta. Për më tepër, pikën 4 nuk e keni prekur, madje qëllimisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë që lidhet me pronësinë e pronarëve kufitarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e përcaktuar shumë qartë ajo çka ne kërkojmë. Ju nuk e keni raportuar dhe baza ligjore së cilës ju i referoheni është e gabuar, sepse e keni detyrim kushtetues (neni 80 i Kushtetutës), ama e keni detyrim edhe në bazë të ligjit “Për statusin e deputetit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është e saktë, madje mund të them se e devijoni qëllimisht edhe ligjin që ju pretendoni se po e përdorni, sepse këto të dhëna nuk kanë karakter sensitiv, në një kohë kur ka një ligj tjetër, që e rregullon këtë pjesë, që është ligji “Për statusin e deputetit”.

Domethënë, çdo gjë që ju keni referuar në shkresën tuaj ose është e mangët, e pjesshme, ose mungon fare. Pra, ju po refuzoni për të dytën herë...

(Zoti Pjetri flet pa mikrofon.)

Çfarë do të përgjigjeni?

(Ndërhyrje pa mikrofon,)

Unë e kam materialin, sepse ma keni dhënë. Njëri propozim është që, nëse ju duhet më shumë kohë, dy-tri orë, jua japim dy-tri orë, madje sillni edhe hartën, se nuk dua të flasim kështu në hava, pa pasur një hartë. Ju e dini shumë mirë që në detyrën që ju kryeni, pa pasur hartën, nuk flitet për pronësinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju nuk mund t’ua mohoni këtë, për më tepër deputetëve të opozitës; me urdhër dhe pa urdhër, e kemi detyrim ligjor!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Propozimi i zonjës Malaj është që t’ju japim disa orë kohë dhe hajdeni na jepni të gjithë pronarët privatë që janë në atë zonë.

Romeo Gurakuqi – Para së gjithash...

Albana Vokshi – Sa kohë ju duhet për këtë? Për këtë po ju pyesim.

Romeo Gurakuqi – Para së gjithash, duhet të sqarojë diçka tjetër zotëria!

Albana Vokshi – Po.

Romeo Gurakuqi – I nderuar zoti drejtor, unë e lexova me vëmendje raportin tuaj. Në fakt, më rezulton se është i ndërtuar me kujdes, por enkas për t’iu shmangur problemeve kryesore.

Unë ju kërkoj përgjigjen e një pyetjeje, që lidhet me atë çfarë keni shkruar ju këtu. Në bazë të pikës 3, ju tregoni se rreth 10625 metra katrorë kanë qenë në pronësi të shtetit italian, të marra në vitin 1938, por, në fakt, rezulton se Teatri Kombëtar, brenda kësaj sipërfaqeje, ka vetëm 5000 metra katrorë.

Ju lutem, a keni mundësi të na tregoni: cila është rruga që ka tjetërsuar më shumë sesa 5000 metra katrorë të tjerë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si janë tjetërsuar? Kjo është përgjigja e pyetjes, që në njëfarë mënyre e bëri edhe zonja, por unë dua ta saktësoj, sepse bëhet fjalë për 5000 metra katrorë. Publiku dëshiron të dijë se ku kanë shkuar 5000 metra katrorë. Si janë tjetërsuar nga pronë publike, pronë e shtetit italian, domethënë shqiptar, për shkak të ligjit të vitit 1945, duke kaluar në pronë të privatit? Si është bërë kjo gjë, kush e ka bërë, koha, viti?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Romeo, ia kemi kërkuar këtë, është e cituar shumë saktë dhe nuk ka kthyer përgjigje as për këtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Në fakt, zoti Pjetri, unë dëshiroj t’u bashkohem kolegëve me një pyetje shumë të rëndësishme. Komisioni i negocimit, që u aprovua nga ligji që kaluam me procedurë të përshpejtuar, do ta ketë mundësinë që ju t’i jepni ato të dhëna, që nuk na i jepni neve? Domethënë, pronën e “Fusha-s”, domethënë sa sipërfaqe ka, do t’ia jepni komisionit të negocimit? Ky komision ka attribute më të mëdha sesa statusi i deputetit, apo ia keni dhënë bashkisë këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Zoti Pjetri, sa kohë ju duhet për të kthyer përgjigjet e pyetjeve që ne bëmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse...

(Zoti Pjetri flet pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – ...informacion shumë i rëndësishëm për mua, zonja kryetare!

Albana Vokshi – Si?

Valdrin Pjetri – Le të saktësojmë diçka, që është shumë e rëndësishme për mua, për pozicionin që unë mbaj dhe për seriozitetin që i kam dhënë këtij komisioni.

Në përgjigjet që ju kam sjellë sot...

Albana Vokshi – Po të ishit serioz, më falni, do t’i kishit kthyer disa përgjigje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni që ju ndërpres, por flisni pak saktë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju kemi thirrur dhe ju lamë kohë për t’ju përgjigjur pyetjeve.

Valdrin Pjetri – Dakord, por më jepni mundësinë të përgjigjem.

Albana Vokshi – Sa ka “Fusha”? Kësaj përgjigjuni, se ishte pyetja e parë që ju bënë!

Milva Ekonomi – Lëreni të flasë dhe ta shpjegojë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Pa merak fare.

Atëherë, për sa u përket pyetjeve që keni renditur këtu, ndoshta...

Albana Vokshi – Jo, nuk janë aty, është shkresa bashkëngjitur.

Valdrin Pjetri – Këtu thotë: “Kartela e pasurisë”.

Albana Vokshi – Është te faqja tjetër. Hapeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hapeni faqen tjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E pra! Nuk abuzoni dot! Mos abuzoni!

Valdrin Pjetri – Nuk po abuzoj!

Albana Vokshi – Mos abuzoni!

Valdrin Pjetri – Jo, zonja kryetare, nuk është fare! Duhet ta kuptoni mirë këtë. Zona kadastrale përbëhet nga 1475 pasuri, kështu që është ndarje administrative. Të mos i ngatërrojmë gjërat!

Nëse këtij komisioni i nevojiten informacione të tjera shtesë, lutem, shkruajini dhe sillini zyrtarisht...

Albana Vokshi – I keni aty të shkruara të gjitha!

Valdrin Pjetri – Për sa jam këtu...

Albana Vokshi – Sa kohë ju duhen për t'ju përgjigjur atyre pyetjeve që keni aty?

Valdrin Pjetri – U jam përgjigjur të gjitha pyetjeve që janë në shkresën tuaj të parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po, pra!

Valdrin Pjetri – Nëse keni pyetje të tjera shtesë, doni informacion shtesë, siç tha deputeti, për sa i përket hartës, unë jam më se i lumtur t'ju jap, sepse kur jap kartelën, hartën e jap dhe e jap!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Zoti Pjetri, sa kohë ju duhet për të përgatitur materialin që ju kemi kërkuar, një më një...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lidhur me pyetjet, si dhe për hartën, që ju nuk e paskeni kuptuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Zonja kryetare...

Albana Vokshi – Sa kohë ju duhet? Dy orë, tri orë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Nuk kam pse t'i shtoj as edhe një presje.

Albana Vokshi – Nuk doni të përgjigjeni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Refuzoni të përgjigjeni? Ju po refuzoni të përgjigjeni?!

Valdrin Pjetri – Jo, absolutisht.

Albana Vokshi – Ju po refuzoni të përgjigjeni para këtij komisioni?

(Deputetja Ekonomi ndërhyr pa mikrofon.)

Përgjigjuni pyetjes së fundit!

Valdrin Pjetri – Do të mbaj qëndrim...

Albana Vokshi – Përgjigjuni pyetjes për pronarët privatë! E keni detyrim kushtetues!

Valdrin Pjetri – Ligji, me të cilin...

Albana Vokshi – Jo, të lutem, Kushtetutën e mbrojmë ne këtu!

Valdrin Pjetri – Unë u jap llogari organeve ligjzbatuese: prokurorisë, organeve të vetingut, ILDKPKI-së dhe Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave!

Albana Vokshi – Nuk i jeni përgjigjur asnjërës prej pyetjeve!

Valdrin Pjetri – Unë mbaj përgjegjësi për të gjitha...

Albana Vokshi – Zoti Pjetri, do t'u përgjigjeni...?

(Zoti Pjetri flet pa mikrofon.)

Atëherë, mbledhja mbyllet këtu.

Nuk ka asnjë informacion. Qeveria nuk do të bëjë transparencë! Kjo është skandaloze!

(Zoti Pjetri flet pa mikrofon.)

Po fshihet vjedhja! Nuk lejojnë të raportojnë!

Sa ka kompania “Fusha sh.p.k”? Sa kanë privatët? Sa ka bashkia?

(Zoti Pjetri flet pa mikrofon.)

Nuk kanë raportuar sa ka bashkia! Mendohuni pak këtu, sepse as bashkia nuk i ka pronat e saj ato që ka raportuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kanë mashtruar me relacionin! Kanë gënjyer me relacionin! E për çfarë? Për të bërë vjedhjen më të madhe!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është vjedhja! A po e kuptoni? Tërhiquni, o deputetë!

(Debat në sallë.)

Kejdi, të lutem!

Mbledhja mbyllet këtu, sepse kryeregjistruesi...

(Deputetja Ekonomi ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, jo, mbledhjen e kemi thirrur ne!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë do të bëni juve? Do të mblidhni informacionin që kemi kërkuar ne?!

(Deputetja Ekonomi ndërhyr pa mikrofon.)

Jemi ne, deputetët e opozitës!

Milva Ekonomi – Le të dëgjojmë përgjigjet që ai ka dhënë!

Albana Vokshi – Nuk ka dhënë asnjë përgjigje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se ju doni të vazhdoni farsën, vazhdojeni, se për këtë keni ardhur sot dhe është krim ky që po bëni!

(Zoti Pjetri flet pa mikrofon.)

Është realisht krim, Milva, kjo që ju po bëni: po mundoheni të fshihni...!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po mundoheni të mos bëni transparencë për atë çfarë po ndodh!

Milva Ekonomi – Shikoje!

Albana Vokshi – Po i jepni 8500 metra katrorë privatit dhe nuk guxoni të thoni sa metra ka ky privat! Mendojeni pak! Po e fshihni sa ka privati! Atë selinë, kompaninë!

(Deputetja Ekonomi flet pa mikrofon.)

Nuk keni guxim ta jepni, sepse Rama...

E ke gabim!

Rama e ka urdhëruar që ta fshehë informacionin!

Milva Ekonomi – Ç'punë ka Rama këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju nuk doni të tregoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rama po i fal, me Veliajn, në shkelje të Kushtetutës...

(Deputetja Mehmetaj flet pa mikrofon.)

Kejdi, e kanë edhe atë, por llogaritë nuk i kanë bërë mirë para se të vinin këtu, sepse nuk dalin ato që na kanë raportuar!

Nuk u ka dalë koha t'i bëjnë llogaritë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbledhja mbyllet këtu.

Ky është turp i madh! Është mungesë transparence, ndërkohë që ne, si opozitë, do të vazhdojmë të bëjmë transparencë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne jemi të vendosur për të bërë transparencë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Valdrin, të lutem, ulu aty, se nuk të kemi dhënë leje ende të lëvizësh!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Zonja Vokshi, nuk ka kuptim tani, nuk mund të ketë mbledhje pas mbledhjeje! A ka Rregullore këtu, a çfarë?

Milva Ekonomi – Do ta diskutojmë.

Albana Vokshi – Çfarë do të bëjnë këta? E kuptojnë sa qesharakë bëhen?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Mbledhja u mbyll!

Bëni një kërkesë tjetër...

Milva Ekonomi – Nuk bëjmë kërkesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Bëni kërkesë tjetër, sipas Rregullores...

Milva Ekonomi – Patjetër.

Luçiano Boçi – ...dhe thërrisni kryeregjistruesin, se sot e kishim thirrur ne!

Milva Ekonomi – Atë do të bëjmë, atë!

Luçiano Boçi – Si do ta vazhduakeni mbledhjen ju, kur e kemi thirrur ne?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mbledhja mbyllet. Ju vazhdoni farsën!

(Diskutime në sallë.)

Luçiano Boçi – Ariana, të depozitohet kërkesa, të dërgohet te...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E bën sekretaria. Pra, depozitohet kërkesa dhe pastaj thirret kryeregjistruesi.

Milva Ekonomi – Patjetër.

Luçiano Boçi – Mbledhja aktuale është e mbyllur ligjërisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, ta thërrasin këta!

Milva Ekonomi – Nuk vazhdon mbledhja jonë, mos ki merak!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – E ka Rregullorja.

Milva Ekonomi – Mos e ki merak, nuk vazhdon dot, jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Ah, në qoftë se keni mbledhje të grupit tuaj parlamentar me kryeregjistruesin, vazhdoni! Suksese!

(Deputetët e opozitës largohen nga mbledhja.)

Milva Ekonomi – Zoti Pjetri, unë besoj një gjë, që informacioni i sjellë prej jush është i plotë, në fakt, dhe nuk besoj se ky informacion ka mangësi, por do t'ju lutesha shumë që në qoftë se deputetët e opozitës kërkuar një informacion shtesë lidhur me hartën dhe ecurinë e pronës nga viti 1938 deri sot, në qoftë se ju keni gjurmë të kësaj ecurie, do të ishte mirë të bënit një narrativë dhe të na e sillnit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valdrin Pjetri – Zonja nënkryetare, për sa i përket informacionit të kërkuar nga ky komision, unë e kam sjellë një kopje dhe do të lutesha ta plotësonte pjesën e kërkuar që janë kartelat e pasurisë.

Unë, si hipotekë, kur jap kartela, nuk e kam problem të jap edhe hartën. Thjesht iu referova pyetjeve të bëra nga komisioni. Pra, nëse doni hartat, jua sjell, por harta doli sot si pyetje gjatë diskutimeve e debateve.

Ne po i mbajmë shënim dhe duke filluar që nesër, pasnesër, ne do t'ju sjellim një kopje...

Bujar Çela – Do t'ju drejtohem ne me një kërkesë ose njëri nga deputetët...

Valdrin Pjetri – ...të hartave pranë këtij komisioni.

Milva Ekonomi – Duke u nisur nga diskutimet që bënë kolegët tanë të opozitës, do të sjellim edhe ne një shkresë me objekt për plotësimin me më shumë informacion, për pajisjen me hartë, me ecurinë e pronës për periudhën 1938-1990 e të tjera me radhë, që të shikohet më shumë nevoja për transparencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Për sa i përket ecurisë së regjistrimit të pronës nga viti 1938, kur është bërë akti noterial dhe është regjistruar në hipotekën e Tiranës, në kadastrën e asaj kohe dhe deri sot ky regjistër pasurish nuk ka pasur transaksione. Kam këtu edhe një kopje të regjistrimit, ku pjesa anësore, pjesa e shënimit të parë, pasi nëse në vitet '60, '70, '90 e të tjerë duhet të kryesh një transaksion, regjistrohet në krahun e djathtë, dokument të cilin e kisha me vete, nuk rezulton të jetë kryer asnjë transaksion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund të jetë bërë ndonjë transaksion, por nuk është depozituar pranë zyrave tona të regjistrimit të pasurive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo pa qëllim i ndan pronë shtet dhe pronë privat, sepse për pronat private nuk mund të jepet informacion, sepse e kufizon Kushtetuta, e kufizon ligji organik.

Një herë që bëhet leximi fillestar, ligji nr. 33/2012 e garanton mosdhënien e informacionit ndaj personave të paautorizuar.

Milva Ekonomi – Në rregull.

Valdrin Pjetri – Megjithatë, mbetem i hapur për çdo informacion shtesë që kërkon ky komision.

Milva Ekonomi – Shumë faleminderit, zoti Pjetri, për të gjitha shpjegimet që na bëtë sot dhe për të gjithë këtë informacion që na vutë në dispozicion!

Do t'u lutesha shumë deputetëve të maxhorancës të qëndronin pak, që të bëjmë edhe ne kërkesën për informacionin që duhet t'i sillni këtij komisioni sa më shpejt të jetë e mundur.

Bujar Çela – Zonja nënkryetare, për procedurë.

Milva Ekonomi – Po, urdhëroni.

Bujar Çela – Për procedurë, kam një pyetje edhe ndaj vetvetes, por edhe...

Me sa kuptoj, historia e debatit që bën opozita nuk është ligjor. Historitë e kartelës dhe të hartës nuk kanë të bëjnë me ne si komision. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe po diskutojmë për diçka që ka kaluar.

E dyta, a ka mundësi të kemi informacion në lidhje me atë që duket si thembra e Akilit, për 10600 metrat, më falni për shifrën e saktë, se si është fati i kësaj ndër vite, ndërkohë kur kryeregjistruesi u shpreh qartë: “Në regjistrat e hipotekës nuk ka asgjë të shënuar që të ketë ndodhur te kjo pronë”?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo do të thotë se kjo pronë figuron pronë e shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë rëndësie ka se e kujt është?

Milva Ekonomi – Jam shumë dakord, Bujar, por kjo pyetje nuk ishte në dokumentin që ka depozituar opozita. Prandaj do t'ia sqarojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – Ju lutem! Diskutimi im është që për këta 10600 metra katrorë, çfarëdo të debatojmë ne sa herë që vjen kryeregjistruesi, do të na sjellë këto shifra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se dihet shumë qartë se ka njëqind e ca hektarë, ajo që unë i kërkoj kryeregjistruesit është shumë transparente: a keni mundësi të na bëni një leksion në lidhje me gjuhën që përdor hipoteka, që edhe ne t'i afrohem kuptimit të asaj që ju thonin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Lidhur me informacionin për këtë komision, u mundova të jem jo shumë teknik dhe hartograf, por përgatita një informacion që të ishte i kuptueshëm për çdo njeri që mban në dorë informacionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Në plotësim të informacionin, në rast se do të kemi një dëgjues tjetër, jam në vazhdim të idesë që tha Bujari, ne duhet t'i referohemi terminologjisë së institucionit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që nis nga regjistri hipotekor, që i referohet vitit 1938, me dokumentet pronësore që përmbajnë qoftë pronat me statusin shtet, qoftë pronat me status privat që këtu nuk lejohet, sipas ligjit, të jepen të dhëna.

Së dyti, të sqarohet marrëdhënia e regjistrimit të pronave sipas ligjit të inventarizimit, të transferimit që ka filluar në vitin 2001.

Me sa shikoj unë në vitin 2015, në vitin 2016, në vitin 2017 janë veprime hipotekore të kryera nga kjo qeveri, sepse në të gjithë periudhën tjetër, kur ka qenë opozita në pushtet, në periudhën 2005-2013, nuk bëheshin fare regjistrime as në pushtetin vendor, as në pronat shtet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është një arritje, sepse këto kanë edhe shpenzime financiare. Pra, qeveria jo vetëm i ka garantuar dhe i ka regjistruar pronat shtet, por kjo është edhe pjesë e transparencës, nuk është pjesë e fshehjes për statusin e pasurisë dhe për raportin ndërtesë – shesh publik – truall e kështu me radhë. Pra, ju duhet të keni parasysh qëndrimin korrekt të terminologjisë së hipotekës: çfarë është pasuria, çfarë është kartela, çfarë janë zonat kadastrale, se nuk është e lehtë. Ti thua që i sjell, por do të sjellësh ti këtu 14751 pasuri, që kanë edhe kosto financiare, por kanë edhe volum të madh pune. Këta nuk i kuptojnë. Këta do të bëjnë show-n e radhës dhe duan të bëjnë atë që bënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që nuk na kushton ndonjë gjë që këto të dhëna, që realisht janë dhe ju i vërtetuat me shumë korrektesë, të pasqyrohen me gjuhë konkrete dhe me referencat konkrete ligjore.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Pjetri!

Faleminderit, zonjë!

Do t'jua sjellim shkresën së shpejti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valdrin Pjetri – Faleminderit juve!

E mirëpresim dhe do t'ju kthejmë përgjigje në kohë reale për çdo kërkesë tuajën.

Milva Ekonomi – Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

